



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 10.07.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 10 dhe 33 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, Marrëveshjes së lidhur me komunitetin e fshatit Korenicë të dt: 13.05.2015, për realizimin e kërkesës së komunitetit të këtij fshati nr. 352-33097 për rivarrimin e martirëve në fshatin Meje dhe raportit të Komisionit për përcjelljen e punëve të rivarrimit të 8 mbetjeve mortore të fshatit Korenicë në kompleksin e varrezave të fshatit Meje, me dt: 10.07.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e komunitetit të fshatit Korenicë nr.352-33097 e dt: 13.05.2015 për mbështetje financiare të zhvarrimit të eshtrave të 8 martirëve të fshatit Korenicë dhe rivarrimit të tyre në kompleksin e varrezave të fshatit Meje të Komunës së Gjakovës, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 3,112.00€ .
2. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerën prej 3,112.00€ nga subvencionet e Zyrës së Kryetares së Komunës, në emër të shërbimeve të kryera nga DPZ “A. Qarri- Loti”, sipas faturës nr. 16/2015 e dt: 09.07.2015, në vlerë prej 3,112.00€ .
3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 3,112.00€ € nga subvencionet e Zyrës së Kryetares së Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e DPZ “A. Qarri-Loti” nr.1140137787000-126, PCB
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .
5. Vendimi iu dërgohet :

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Shërbime Publike
- DPZ. “A. Qarri-Loti”
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila